

VENDIM
Nr. 846, datë 27.9.2013

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË, TË DISA OBJEKTEVE DHE
TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË E PRONËS NR. 84, ME EMËRTIM “ISH-REGJIMENTI I
KIMISË”, ME VENDNDODHJE NË SHTISH-TUFINË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM
NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të disa objekteve dhe truallit funksional të tyre, me sipërfaqe të përgjithshme 37 100 (tridhjetë e shtatë mijë e njëqind) m², pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-Regjimenti i Kimisë”, me vendndodhje në Shtish-Tufinë, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, për t’i përdorur për ngritjen e një vendqëndrimi për strehimin e familjeve të komunitetit rom.

2. Sipërfaqja prej 37 100 (tridhjetë e shtatë mijë e njëqind) m², pjesë e pronës nr. 84, me emërtim “Ish-Regjimenti i Kimisë”, me vendndodhje në Shtish-Tufinë, Tiranë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e sipërfaqes së kësaj prone, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministri i Punëve të Brendshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama